

Rezultatet e studimeve të shkencëtarëve të Fakultetit të Mjekësisë në Universitetin në New York treguan se prania e nënës ndikon në funksionimin e trurit të foshnjës.

Në studim thuhet se prania e nënës është një parametër i rëndësishëm kur fëmija ndjen dhimbje.

Shkencëtarët amerikanë kanë kryer teste në minj të cilëve ju dhanë elektroshok të lehtë.

Me këtë rast kanë zbuluar se gjatë dhimjeve aktivizohen disa qindra gjene në zonën e trurit që kontrollon emocione.

Megjithatë kur nëna e tyre ishte aty pranë, ky numër u reduktua në më pak se 100.

"Studimi jonë ka treguar se nëna e cila ngushëllon foshnjën, që ka dhimbje, nuk shkakton vetëm reagim mental. Vetë akti i ngushëllimit pon në ndryshimë në rrjetet neurale që janë vendimtare për zhvillimin e hershëm të trurit", thotë udhëheqësja e studimit dhe neurobiologiste Regina Sullivan./AA/